Një ankesë kundër: **Autoritetit Kontraktues – KOMUNA E GJAKOVËS**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **632-26-5866-2-1-1**

Sa i përket tenderit për **"Sinjalizimi rrugor në Qerim, Piskot, Berkoc, Blloku i ri, Has, reka keqe, reka mirë"**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

"TSR" Sh.P.K.

Rr. "Fehmi Lladrovci" nr. 99

Fushë Kosovë *12000*

+383 (0)44 34 13 68

Marksim Malsijaj, Drejtor

info@tsr-ks.com

05.11.2026

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës","Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

B05 Njoftimi për Kontratë & Dosja e Tenderit – 20.07.2026 *Sqarimet shtesë – 12.08.2026* *B58 Njoftimi mbi Vendimin – 22.10.2026* *Kërkesa për rishqyrtim – 27.10.2026* *Vendimi mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim – 04.11.2026*

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po [X] **Jo** [ ]

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po [X] **Jo** [ ]

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po [X] **Jo** [ ]

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se. *Kërkesa për rishqyrtim – 27.10.2026* *Vendimi mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim – 04.11.2026*

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 59 par. 4 i LPP.

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

AK e ka publikuar njoftimin mbi vendimin përmes të cilit ka rekomanduar për kontratë OE "Traffiks VA" shpk ndërsa ofertën tonë e ka eliminuar si të papërgjegjshme. Vendimi i AK është i kundërligjshëm dhe i gabuar në tërësi për faktin që oferta jonë i ka përmbushur të gjitha kërkesat e DT dhe kriteret për dhënien e kontratës ndërsa pikërisht oferta kundërshtare e rekomanduar nga AK për kontratë është e papërgjegjshme sepse nuk i

ka plotësuar as për së afërmi kërkesat e DT. Me fjalë të tjera arsyet eliminuese të prezantuara nga AK janë të pabazuara. Prandaj përmes kësaj kërkese për rishqyrtim kërkojmë që aktiviteti i prokurimit të kthehet në rivlerësim në mënyrë që të konfirmohet se oferta jonë (TSR SHPK) jo vetëm që është e oferta më e lirë por edhe oferta e vetme e përgjegjshme në këtë aktivitet të prokurimit. Në vijim do të prezantojmë pretendimet tona ankimore të bazuara në argumente të matshme, të ligjshme dhe të pakontestueshme.

Fillimisht duhet cekur se oferta jonë është më e lirë sesa oferta e tenderuesit të rekomanduar. Prandaj injorimi nga AK duke kaluar drejtpërdrejtë te tenderuesi më i shtrenjtë pa bërë as përpjekjet minimale për të sqaruar paqartësitë eventuale lidhur me përgjegjshmërinë e ofertës tonë, është mjaft shqetësuese. Kjo për arsye se bëhet fjalë për dëmtimin e drejtpërdrejtë të buxhetit të AK në mënyrë të panevojshme.

Sidoqoftë, këto janë arsyet e prezantuara nga AK për eliminimin e ofertës tonë:

1. Kontrolleri i semaforit nuk është SIL3;
2. Modulet e semaforit SCAE TRAFLET nuk e kanë temperaturën -40 +60 C^o (por -40+65C^o), shkalla e mbrojtjes nuk është IP65 por IP55,
3. Autorizimi nga EKALDES për shtylla LED dhe drita LED nuk është sipas ST të përcaktuara në aneksin 1;
4. Pajisja nr. 8 në listë "makinë për realizimin e sinjalizimit horizontal me ngjyrë termo-plastike me kapacitet min. 400 litra" sipas AK nuk e ka kapacitetin 400 litra!

Para se të argumentojmë se të gjitha arsyet eliminuese janë të pasakta dhe të pavërteta, duhet cekur faktin që me datë 12.08.2026 para hapjes së ofertave AK ka ofruar disa sqarime shtesë lidhur me kërkesat e DT. Në kuadër të këtyre sqarime, AK ndër të tjera ka specifikuar si vijon: "***ju mund të ofroni me produkte më të avancuara apo ekuivalente mirëpo produktet që ofroni për të instaluar duhet të kenë formën dhe dizajnin e kërkuar në FDT***".

Duke marrë parasysh këtë sqarim të ofruar nga AK, ne kemi vendosur që të ofertojmë në këtë aktivitet të prokurimit. Kjo për arsye se sqarimet nga AK para hapjes së ofertave janë të njëjta për nga efekti juridike sikurse me kërkesat e DT. Për më tepër edhe në nenin 28 par. 6 dhe 7 përcaktohet shprehimisht "***nëse zgjidhja e propozuar nga tenderuesi në mënyrë ekuivalente plotëson kërkesat e definuara në specifikim teknik, autoriteti kontraktues nuk mund të refuzoj tenderin me arsyetimin se produkti ose shërbimi i ofruar nuk përputhet me specifikimet teknike të formuluara***".

Në rastin konkret sa i përket arsyes eliminuese të AK kinse kontrolleri i semaforit nuk është me standardin e sigurisë SIL3, nuk qëndron konstatimi se ne nuk e plotësojmë kërkesën e AK-së për siguri të kontrollerit vetëm sepse dokumentacioni i VEGA-s nuk mban etiketën formale "SIL3". FDT vetë kërkon një sistem maksimal sigurie me verifikim software, monitorim të programit, memorie të mbrojtur, power monitoring, independent conflict monitoring dhe output monitoring. VEGA i realizon këto funksione përmes një arkitekture të pavarur, redundante dhe fail-safe. VEGA përmban monitorim të pavarur hardware/software të konflikteve red/green nga procesor i dedikuar, sensor redundant të daljes së gjelbër, matje të tensionit dhe rrymës në çdo dalje, hardware/software watchdog, programmed-data check, hardware-configuration check, redundant congruence control of output status, Intergreen Matrix enforcement, time-out control dhe power monitoring. Në gjendje të pasigurt sistemi kalon në emergency/flashing state. Për më tepër, DoP e VEGA-s identifikon EUROFINS Modulo Uno nr.0085 dhe deklaron konformitet me EN50556:2011, EN12675:2000 dhe EN50293:2012, Safety of Signals Class AF5, Controls Class AG4 dhe Operating Safety sipas EN12675. EN12675 është standardi sektorial për functional safety të traffic signal controllers. Prandaj në kuptim të nenit 28 par. 6 të LPP, ne jo vetëm që kemi

dëshmuar se produkti ynë është ekuivalent me SIL3 në aspektin e sigurisë, mirëpo në fakt produkti ynë i tejkalon në shumë aspekte këto standarde në kontekst të ekuivalencës funksionale dhe komparative.

SECURITY

VEGA security functions are based on a redundant control circuit system structured on diversified hardware/software modules.

The system is managed by several processors and hardware circuitry as follows:

- Analogue sensors to measure the voltage applied to the traffic light driven by each controller output (redundant sensor on green lamp).
- Analogue sensors to measure the current flowing into the traffic light driven by each controller outputs.
- Indipendent hardware and software conflict monitoring security function for green and red output performed by a specific processor.
- Each I/O card processors performing:
  - Light diagram congruence control.
  - Current check.
  - Automatic lamp monitoring that notifies lamp failure of any colour and any signal group.
- Hardware and software watch dog.
- CPU processors performing:
  - Programmed data check.
  - Hardware configuration check.
  - Redundant congruence control of output status.
  - Filter action on logic command to respect the Intergreen matrix.
  - Time out control.
  - Main supply voltage measuring and control.
  - Site ID protection.



The occurring of the above said security control will put the controller into an emergency condition where all amber outputs can be flashing.

SOFTWARE CONFIGURATION

Figura - SCAE VEGA - SECURITY: redundant/diversified HW/SW, conflict monitoring, watchdog, output congruence, Intergreen Matrix dhe safe state.

the construction product according to Annex V of UE Reg. n°305/2011	
Laboratorio notificato e numero di accreditamento *Notified product certification body & number*	EUROFINS Modulo Uno - n° 0085
Ha rilasciato Certificato di conformità alle norme tecniche dichiarate: *Issued certificate of Conformity in accordance with the declared technical standards:* EN50556-2011, EN 12675-2000, EN 50293-2012	

PRESTAZIONE DICHIARATA
DECLARED PERFORMANCE

Caratteristiche essenziali ***Essential characteristics***	**Prestazioni** ***Performances***	**Norma Tecnica** ***Harmonised technical standard***
Alimentazione *Power supply*	230Vac +15% -20% // 50Hz +/-5%	EN50556-2011
Contenitore *Housing*	Classi: V2 (IP55) // IK07	EN50556-2011
Sicurezza dei segnali *Safety of signals*	Classe AF5	EN50556-2011
Controlli *Controls*	Classe AG4 (< 300mS)	EN50556-2011
Sicurezza funzionale *Operating safety*	Conformità alla norma *In accordance with standard*	EN 12675-2000
Compatibilità EMC *EMC compatibility*	Conformità alla norma *In accordance with standard*	EN 50293-2012
Si rilascia la presente dichiarazione di prestazione sotto la responsabilità esclusiva del produttore *This declaration of performance is issued under the sole responsibility of the manufacturer*		

Figura VEGA DoP: EUROFINS Modulo Uno nr.0085; EN50556, EN12675; Safety of Signals AF5; Operating Safety EN12675.

Sa i përket arsyes eliminuese sipas të cilës modulet e semaforit SCAE TRAFLET nuk e kanë temperaturën -40 +60 Cº (por -40+65Cº) dhe shkalla e mbrojtjes nuk është IP65 por IP55, duhet sqaruar si vijon:

- FDT kërkon “LED moduli - IP65 protection”. AK ka përdorur IP55 të signal head/housing si bazë refuzimi dhe ka konkluduar se TRAFLED nuk e plotëson IP65. Kjo është krahasim i dy komponentëve të ndryshëm. Dokumentacioni TRAFLED jep optical unit/LED module me protection degree EN60529: IP65, ndërsa produkti është slim design. Prandaj arsyeja IP65 duhet të hiqet si konstatim faktikisht i gabuar.




Figura TRAFLED: slim design dhe optical unit / LED module me IP65.

Ngjashëm nuk qëndron as konstatimi i AK që produkti ynë të konsiderohet teknikisht i papërshtatshëm pa u vlerësuar certifikimi EN12368 që vetë AK e ka kërkuar. TRAFLED është i certifikuar për Environmental Classes A-B-C. Sipas EN12368: Class A shkon deri +60°C, Class B deri +55°C dhe Class C mbulon temperaturën e ulët deri -40°C. Pra certifikimi A-B-C mbulon ekstremet standarde -40°C dhe +60°C. Vlera +65°C është kërkesë shtesë numerike e FDT-së, jashtë kufirit maksimal të klasifikimit A/B/C të vetë standardit. Diferenca minimale (e papërfillshme) prej 5°C, kërkojmë që ajo të vlerësohet sipas nenit 28.6 dhe nenit 59.4 në kontekstin e standardit EN12368 të kërkuar dhe, mbi të gjitha, me të njëjtin standard që AK ka përdorur ndaj ZIRSlim të fituesit. Nëse ZIRSlim moduli dhe certificata e presantuar EN është pranuar vetëm me A/B/C pa provë +65°C, refuzimi i TRAFLED për të njëjtën bazë është i pabarabartë.

Pra si fillim, konstatimi nga AK është i pasaktë. Mirëpo edhe po të ishte i saktë, sërish kjo nuk do të mund të qëndronte si arsye eliminuese sepse përbën devijim të vogël në kuptim të nenit 45 par. 17 dhe par. 19 të RRPP lidhur me nenin 59 par. 4 të LPP ku shprehimisht thuhet se AK do të pranojë ofertat “***në raste të gabimeve ose paqartësive dhe në raste të devijimeve të vogla***”. Përndryshe AK ka pasur mundësi që në kuptim të nenit 72 të LPP të kërkojë sqarime shtesë me ç’rast ne kishim për të ofruar të gjitha sqarimet e nevojshme dhe kundër-argumentet e mjaftueshme lidhur me këto arsye eliminuese të pabazuara.

Sa i përket arsyes eliminuese sipas të cilës kinse autorizimi nga EKALDES për shtylla LED dhe drita LED nuk është sipas ST të përcaktuara në aneksin 1, duhet të sqarohet si vijon:

Në vendimin e vet, AK ka pranuar se dimensioni bazë i bollardit Ekaldes mund të modifikohet nga prodhuesi sipas kërkesës dhe këtë kriter e ka vlerësuar “plotëson”. Kjo

pranon premisën themelore se Ekaldes është prodhues dhe produkti final mund të konfigurohet sipas FDT-së. Nuk është konsistente që personalizimi të pranohet për dimensionin, por të refuzohet për dy shiritat 3M, konfigurimin 360°, numrin e LED-ve apo elemente të tjera vetëm pse nuk shfaqen në një fotografi referuese.

Elasticiteti/memory effect nuk mund të vlerësohet nga një fotografi statike. Po ashtu, "nuk është treguar numri i LED-ve" është mungesë informacioni, jo provë pozitive se prodhuesi nuk mund ta ofrojë konfigurimin e kërkuar. Nëse AK kishte paqartësi, neni 38.4 i Rregullores parashikon qartësimin e deklaratave/certifikatave të paqarta në kushte të njëjta për të gjithë operatorët.

teknike nga Aneksi 1 i dosjes së tenderit për për këto dy pajisje rezulton:

2.1	KËRKESA për Shtyllat fleksibile me LED drita në maje për vendkalim të këmbësorëve		Produkti i EKALDES
1	Dimensionet e shtyllës	**Ø130 x 774mm**	Min. Ø125 x 700mm, mirëpo prodhuesi deklaron se mund të modifikohet sipas kërkesës – plotëson kërkesën
2	Materiali i shtyllës	**PU (Poliuretan)**	aluminium / PU – plotëson kërkesën
3	Ngjyra e shtyllës	**E Hirit Antracid (RAL 7016)**	Sipas kërkesës të gjitha ngjyrat – plotëson kërkesën
4	Folia reflektive	**E vendosur në maje të shtyllës me dy shirita me folie 3M apo e ngjashme (ngjyra: e bardhë ose e verdhë)**	Nuk ka, nuk është paraqitur as në fotografi **– Nuk plotëson kërkesën**
5	Rezistenca në goditje	**Trup elastik me memorie i cili pas goditjes kthehet në gjendje paraprake**	Nuk është elastik, nuk është paraqitur as në fotografi **– Nuk plotëson kërkesën**
6	Përbërja e shtyllës	**Unazë me drita LED e vendosur në maje e dukshëm 360 shkallë**	Dritat LED të vendosura përgjatë shtyllës e jo në maje të dukshëm 360 shkallë **– Nuk plotëson kërkesën**

Figura - Vendimi i AK-së për bollardin Ekaldes: personalizimi pranohet për dimensionin, por pika të tjera refuzohen sepse "nuk janë paraqitur në fotografi".

Dokumentacioni teknik Ekaldes e përshkruan sistemin me "custom extruded aluminium profile casing" dhe parashikon prodhimin e profileve sipas dimensioneve/specifikimeve të vizatimit teknik. Kjo tregon kapacitet prodhues për konfigurim sipas projektit, jo domosdoshmërisht produkt me një gjatësi të vetme fikse. Për Matrix110°, PLCC6 3535, IP67/IK10 dhe materiale, nëse AK ka vlerësuar se dokumentacioni nuk ishte mjaft i qartë, duhej të dallonte "nuk tregohet" nga "nuk e ploteson kërkesën" dhe të aplikonte sqarimin në të njëjtat kushte.

System Specifications

a solid aluminum cover-supported box mounted inside a custom extruded aluminum profile casing , a silica- coated LED signal transmitter module secured with plastic holders to prevent liquid contact, an electronic circuit control board that manages variable signals from an external system source, and a 24V DC internal power supply.

uses a power supply that provides AC 220V input - DC 24 volt output, receiving AC 220V variable signals from an external circuit source via a 5*0.50 NYAF cable. The product is controlled by an electronic circuit control board that is powered by electricity. The electronic circuit board, which converts the AC 220V variable signals from the external system source into a DC 24-volt output, powers the LED modules and provides a homogeneous light distribution with the support of the solid material on the casing. The product casing features UV printing with liquid-resistant logos, names, or directional markings.

Extrusion: A process of continuously shaping materials under pressure, both in hot and cold states.

Figura - Ekaldes: "custom extruded aluminium profile casing" dhe arkitekturë e konfigurueshme e sistemit.

2.2	Kërkesa për Dritat tërthore LED për vendkalim të këmbësorëve		Produkti i EKALDES
1	Burimi i energjisë	**Solare ose lidhje në rrjetin elektrik**	Plotëson kërkesën
2	Vendosja në sipërfaqe	**E rrafshët jo mbi ose nën nivelin e sipërfaqes së rrugës, toleranca +- 0.5 mm**	Në bazë të fotografive – plotëson kërkesën
3	Dimensionet për copë	**1000 x 100 x 48 mm**	Dimensionet e ofruara: 1480mm, 1480mm dhe 2200mm, gjerësia 163 mm– **Nuk plotësojnë kërkesën**
4	Temperatura e punës	**-25 ºC deri +85ºC**	-30° C to + 85°C – plotëson kërkesën
5	LED konfigurimi	**Matrix 110°**	Nuk tregohet - **Nuk plotësojn kërkesën**
6	Tipi i LED-it	**RGB PLCC6 3535**	Nuk tregohet - **Nuk plotësojn kërkesën**
7	Shkalla e mbrojtjes	**IP67, IK10**	Nuk tregohet - **Nuk plotësojn kërkesën**
9	Materiali i mbështjellësit dhe bazës	**Çelik inox, polikarbonat, baza nga alumini**	Ka bazë të aluminit mirëpo mungon pjesa e sipërme pre çelikut inox - **Nuk plotësojn kërkesën**
10	Ngjyrat e LED-it	**kuq, verdhë dhe gjelbër**	Plotëson kërkesën
11	Mënyra e operimit të dritës	**Dritë pa ndërprerje-konstante dhe mundësia me dritë pulsive**	Në bazë të fotografive - Plotëson kërkesën
12	Certifikimi – Deklarimi i Konfirmitetit, të	**1. Në përputhje me standardin: IEC 60598-2-13:2006 +**	Të ofruara EN 12368:2006, EN 40-5:2002, EN 40-6:2002, ISO 9001:2015, ISO

Figura - Vendimi i AK-së për Ground LED Ekaldes: disa pika konsiderohen mosplotësim vetëm me formulimin "nuk tregohet".

Ne kemi dorëzuar dokumentacion teknik zyrtar të prodhuesit me standarde, materiale, parametrat elektrikë/mjedisorë dhe vizatimet teknike. Nëse AK ka konsideruar se forma dokumentare nuk përbënte EU Declaration of Conformity të veçantë në formatin që priste, kjo është çështje dokumentare që duhej të vlerësohej sipas neneve 72 LPP dhe 38 të RRPP, për aq sa dokumenti plotësues objektivisht vërteton një gjendje që ekzistonte para afatit dhe nuk ndryshon produktin.

Ky argument forcohet nga krahasimi me ofertën e fituesit: për SR-CITY-BALI-TL-R, në arkivin e deklaratave të qasshme nuk identifikohet EU DoC i modelit, megjithatë oferta është vlerësuar e përgjegjshme. Nuk mund të

Për të shmangur çdo keqkuptim, ne nuk kërkojmë që AK të lejojë ndryshimin e produkteve pas afatit. Sqarimi është i ligjshëm kur provon një karakteristikë ose dokument që i përket produktit/pajisjes së identifikuar dhe kur ekzistenca e asaj gjendjeje ka qenë e fiksuar para afatit. Në të kundërt, zëvendësimi i produktit, mbledhja e parametrave nga dy modele të ndryshme, ndryshimi i teknologjisë apo krijimi i një konfigurimi materialisht të ri pas afatit nuk është sqarim i lejuar.

Për TSR një deklaratë e prodhuesit që sqaron një konfigurim që ka qenë pjesë e produktit të ofertuar mund të jetë sqarim; zëvendësimi me produkt tjetër nuk do të ishte. Për TRAFFIKS: tabela e munguar e një certifikate mund të pranohet vetëm nëse ka ekzistuar si pjesë e certifikatës para afatit dhe mund të verifikohet objektivisht; nuk mund të krijohet pas afatit, dhe ne te njëjtën kohe nuk mund te përdoret një produkt i një prodhuesi, duke i zëvendësuar mangësitë nga katalogu i prodhuesit tjetër, Po ashtu, karakteristika e modelit TSL-R nuk mund të transferohet te TL-R nëse kjo do të ndryshonte produktin e ofertuar.

Sa i përket arsyes eliminuese kinse pajisja nr. 8 në listë "makinë për realizimin e sinjalizimit horizontal me ngjyrë termo-plastike me kapacitet min. 400 litra" sipas AK nuk e ka kapacitetin 400 litra, duhet sqaruar si vijon:

Kërkesa në DT ka qenë e formuluar si vijon:

Operatori Ekonomik duhet të posedojë mjete, stabilimentet dhe pajisjet teknike që janë të domosdoshme për realizimin e projektit Pasjet dhe mekanizimi i obligueshëm sipas tabelës në Aneksin 7 të DT.	Deklaratat unike doganore ose kontrata fatura e blerjes për automjetet që nuk regjistrohen dhe Librezat e qarkullimit për automjetet që regjistrohen. Në rastet kur Operatori Ekonomik ka marrëveshje për shfrytëzimin, Operatori Ekonomik duhet të dorëzoj edhe marrëveshjen për shfrytëzim.

Pra me DT është kërkuar që si dëshmi dokumentare të dorëzohet DUD ose faturë dhe libreza për pajisjet që regjistrohen. Në rastin konkret AK nuk e konteston që ne i kemi dorëzuar këto dëshmi mirëpo sërish na eliminon për shkak të një dëshmie tjetër që nuk e ka kërkuar me DT (dhe as në arsyen eliminuese nuk e precizon se cili është ky dokument për të cilin ne po eliminohemi). Me respekt e potencojmë faktin që AK nuk mund të shtoj kërkesa të reja në DT pas hapjes së ofertave. Sidoqoftë, për të vërtetuar faktin që pajisja e prezantuar në ofertën tonë është sikurse pajisja e kërkuar me DT, AK ka pasur mundësi të kërkoj sqarime shtesë ose edhe më mirë kishte për të qenë nëse AK do të vinte në fabrikën tonë dhe të verifikonte personalisht kapacitetin e pajisjes. Në këtë mënyrë AK ka pasur mundësi të bindet se pajisja jo vetëm që ka kapacitet prej 400 litra mirëpo në fakt ka kapacitet shumë më të madh sesa 400 litra. Megjithatë në formën sikurse ka vepruar AK, edhe kjo arsye eliminuese është e pasaktë dhe e pavërtetë.

Nga sa u tha më sipër është argumentuar mjaftueshëm dhe në mënyrë të pakontestueshme se oferta jonë është tërësisht e përgjegjshme sepse i përmbush të gjitha kërkesat e DT. Ndërsa arsyet eliminuese të prezantuara nga AK janë të pasakta dhe të pavërteta.

Përndryshe, nga analiza krahasuese rezulton se oferta e operatorit të rekomanduar përmban së paku disa çështje që janë po aq ose më serioze se ato për të cilat është eliminuar TSR SH.P.K.: mungesë e identifikueshme e certifikatave të kontrollerit; deklarim SIL3 në katalog pa certifikatë të identifikuar; certifikatë ZIRSlim e vetëm 2/23 faqe që nuk përmban tabelat ku provohen intensiteti dhe phantom signal; mosdëshmi 210 mm; mungesë e provës +65°C në dokumentet e kontrolluara; mungesë e EU DoC të identifikuar për bollardin TL-R; "Linear 110°" në vend të "Matrix 110°".

Nëse këto çështje janë konsideruar të sqarueshme, ekuivalente ose jo-materiale për TRAFFIKS VA, atëherë i njëjti standard duhet të zbatohet për VEGA, TRAFLED dhe Ekaldes. Nëse, në anën tjetër, AK mban standardin strikt që ka përdorur kundër TSR - **"nuk është në katalog/certifikatë, prandaj nuk plotëson**" - atëherë i njëjti standard duhet të çojë në rivlerësimin dhe, **për mospërputhjet materiale të provuara, dhe mosdorëzim te certifikatave, refuzimin e ofertës së operatorit të rekomanduar.**

Nuk mund të ekzistojë një standard "strict compliance" për ofertën më të lirë të TSR SH.P.K. dhe një standard "substantial/equivalent compliance" për TRAFFIKS VA. LPP lejon ekuivalencë dhe sqarim, por vetëm nën parimin e trajtimit të barabartë. Standardi juridik duhet të jetë i njëjtë për të dy operatorët. Prandaj në vijim po prezantojmë si pretendime argumentet tona sipas të cilave oferta e tenderuesit të rekomanduar jo vetëm që është më e shtrenjtë sesa oferta jonë por edhe është totalisht e papërgjegjshme sepse nuk përmbush as për së afërmi kërkesat e DT.

I. OBJEKTI, HISTORIKU PROCEDURAL DHE THELBI I KËRKESËS

TSR SH.P.K. kundërshton rezultatin e rivlerësimit të aktivitetit të prokurimit në të cilin oferta jonë fillimisht u shpall e papërgjegjshme, ndërsa TRAFFIKS VA SH.P.K. u rekomandua për kontratë. Pas kërkesës sonë paraprake për rishqyrtim, aktiviteti është kthyer në rivlerësim. Gjatë këtij rivlerësimi, Autoriteti Kontraktues i ka dërguar vetëm TRAFFIKS VA një kërkesë B47 për informata/sqarime lidhur me katër mungesa të identifikuara në ofertën e tij: certifikatat EN 50556 dhe EN 12675 të kontrollerit, EU Declaration of Conformity të bollardit, provën e statusit të Elektromodul-Promet si përfaqësues/diler i ZIR dhe certifikatën SIL3.

TSR SH.P.K. nuk është trajtuar në të njëjtën mënyrë. Për çështje të së njëjtës natyrë - dokumente të konsideruara të pamjaftueshme, deklarim SIL3, forma e EU Declaration of Conformity, karakteristika të produkteve custom dhe paqartësi teknike - AK nuk na ka kërkuar sqarim para eliminimit, por i ka përdorur drejtpërdrejt si arsye për papërgjegjshmëri. Në rivlerësim, në vend që mekanizmi i sqarimit të aplikohej në kushte të njëjta për të dy operatorët, ai është përdorur vetëm për operatorin me çmim më të lartë, TRAFFIKS VA.

Ne kemi kërkuar që sqarimi të përdoret kur një dokument vetëm qartëson një gjendje ekzistuese dhe nuk ndryshon tenderin. Kundërshtimi ynë është se: (i) ky mekanizëm nuk është zbatuar njësoj për TSR; (ii) disa nga dokumentet e sjella nga TRAFFIKS nuk janë dokumentet që kërkoi FDT/AK; (iii) disa i referohen modelit tjetër të produktit; (iv) disa nuk dëshmojnë gjendje ekzistuese në momentin juridikisht relevant; dhe (v) një numër mospërputhjesh të ngritura në kërkesën tonë të parë nuk janë trajtuar fare në rivlerësim.

Parimi qendror i kësaj kërkese
Nuk mund të aplikohet "strict compliance" dhe eliminim pa sqarim ndaj TSR SH.P.K., ndërsa ndaj TRAFFIKS VA të lejohet plotësimi pas afatit i dokumenteve që FDT i kërkon shprehimisht me ofertë. Ose paqartësitë e së njëjtës natyrë janë të sqarueshme për të dy operatorët, ose mungesat materiale kanë të njëjtën pasojë për të dy.

II. INTERESI JURIDIK DHE DËMI I SHKAKTUAR / I KËRCËNUAR

TSR SH.P.K. është palë e interesuar sepse ka dorëzuar ofertë të vlefshme në këtë aktivitet dhe oferta jonë është financiarisht më e ulët: 112,985.00 €, krahasuar me 118,454.60 € të TRAFFIKS VA. Kriteri i dhënies është tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët.

Prandaj, trajtimi i pabarabartë i sqarimeve dhe pranimi i dokumenteve të TRAFFIKS që nuk plotësojnë kërkesën në të njëjtën formë siç është kërkuar nga TSR ndikon drejtpërdrejt në rezultatin e aktivitetit dhe i shkakton TSR-së dëm material dhe procedural.

III. BAZA LIGJORE DHE RREGULLAT QË DUHET TË ZBATOHEN

- Neni 7 i LPP-së kërkon trajtim të barabartë, jo-diskriminues dhe transparent të operatorëve ekonomikë. Ky detyrim përfshin jo vetëm tekstin e FDT-së, por edhe mënyrën se si AK kërkon prova, lejon sqarime dhe vlerëson materialitetin e mangësive.
- Neni 28.6 i LPP-së lejon zgjidhje ekuivalente kur ekuivalenca dëshmohet me mjete të përshtatshme. Ky parim nuk mund të zbatohet vetëm ndaj një operatori.
- Neni 59.2 i LPP-së lejon sqarim me shkrim, por jo ndryshim të një kushti material të tenderit. Neni 59.4 kërkon përputhje me kërkesat e FDT-së dhe lejon vetëm korrigjime/devijime jo-materiale.
- Neni 38.3 i Rregullores Nr.001/2022 lejon kërkimin e informatave ose dokumenteve që mungojnë vetëm kur ato, në mënyrë objektive, japin prova të mjaftueshme që pasqyrojnë gjendjen ekzistuese para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve. Në këtë aktivitet afati ishte 31.08.2026. Ky mekanizëm nuk lejon që pas afatit të krijohet një certifikim, autorizim, identitet produkti ose përputhshmëri teknike që nuk ka ekzistuar në atë moment.
- Neni 38.4 i Rregullores kërkon shprehimisht që mundësia për informacion shtesë të sigurohet në kushte të njëjta për të gjithë operatorët ekonomikë dhe që sqarimi i deklaratave/certifikatave të paqarta të jetë pjesë e procedurës së vlerësimit.
- Neni 40.8 i Rregullores lejon sqarim për ekzaminimin dhe krahasimin e tenderëve, pa ndryshim të çmimit ose të një aspekti material.
- Neni 108/A i LPP-së dhe nenet 59-63 të Rregullores rregullojnë kërkesën për rishqyrtim dhe efektin pezullues të saj.


Rregulli i posaçëm i FDT-së
FDT kërkon katalogë të detajuar për produktet e semaforëve, sinjalizimit horizontal/vertikal dhe pajisjet me sinjale ndriçuese, në përputhje të plotë me specifikimet teknike. Vetë FDT paralajmëron se katalogët do të krahasohen produkt për produkt dhe, nëse katalogu nuk plotëson specifikimin teknik, oferta do të refuzohet.


pranohet në ofertim.
Ju sqarojmë se trashësia e ngjyrës së thjeshtë, përkatësisht specifikimi teknik i saj pranohet edhe në vlerat nga 0.6-1 mm trashësi.
Po ju mund të ofertoni me produkte më të avancuara apo ekuivalente mirëpo produktet që ofroni për të instaluar duhet të kenë formën dhe dizajnin e kërkuar në FDT-të dhe të plotësojnë karakteristikat minimale teknike të shprehura në FDT-të po ashtu të kenë EU-Deklaratën e Konformitetit që tregon se pajisjet ndriçuese janë në përputhje me standardet e BE-së të kërkuara në Aneks 1 Komuna e Gjakovës siç edhe mund të lexoni në Aneksin 1 dhe paramasë ka 8 udhëkryqe me semafor. Serveri që

Figura 1. Sqarimi zyrtar i AK-së i datës 12.08.2026: lejohen produkte më të avancuara ose ekuivalente, por duhet të plotësohen minimumet teknike të FDT-së.

IV. VETË AK KA KONSTATUAR MUNGESAT E TRAFFIKS VA NË RIVLERËSIM

Kërkesa B47 e AK-së është provë e drejtpërdrejtë se çështjet e ngritura nga TSR nuk ishin hipotetike. AK vetë ka konstatuar se në ofertën e TRAFFIKS VA mungonin dokumente që FDT i kërkonte dhe ka kërkuar sqarim/plotësim për katër pika. Në të njëjtën letër AK ka kërkuar që dokumentet të jenë para datës së hapjes 31.08.2026. Pikërisht këtu duhet zbatuar testi i nenit 38.3: dokumenti i sjellë pas afatit mund të pranohet vetëm nëse dëshmon objektivisht një gjendje që ka ekzistuar para 31.08.2026 dhe nuk ndryshon asnjë aspekt material të tenderit.



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO

GJAKOVA

KOMUNA E GJAKOVËS

OPŠTINA DJAKOVICA/ MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Letër Standarde e kërkesës për informata mbi tenderët

Gjakovë: 12.10.2026

KOMUNA E GJAKOVËS, Rr "Nënë Tereza" 50000 GJAKOVË

Për: TRAFFIKS VA SH.P.K., Radovan Zogovic B1, C3, H2 /27, 10000, Prishtine

Nr. i prokurimit:	**632-26-5866-2-1-1**
Nr i brendshëm	**632-26-041-211**

Titulli: Sinjalizimi rrugor në Qerim,Piskot,Brekoc,Blloku i ri,Has,reka e keqe,reka mirë.

I/e nderuar(a) /Z/Znj]
Faleminderit që morët pjesë në procedurën e lartshënuar të prokurimit publik.
Procedura është udhëhequr në pajtim me Ligjin për Prokurimin Publik Nr. 04/L-042, , i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, siç citohet në vazhdim "LPP".

11. Krijimi i një grupi te operatoreve ekonomik

11.1 Nëse një tender dorëzohet nga një grup i operatorëve ekonomik, grupi është i detyruar të **emëroj njërin nga anëtarët** e grupit si operator ekonomik kontaktues dhe duhet të prezantoj me tenderin e tij dokumentet **e shënuar në FDT**.

SQARIM:

1.Ju si Operatorë Ekonomik nuk e keni prezantuar certifikatat EN 50556 – Road Traffic Signal system dhe EN 12675 – Traffic signal controllers – Functional safety requirements si dokumente të veçanta, të cilat janë kërkuar që të dorëzohen me ofertë.

2.Nuk e keni prezantuar EU deklarimin e konformitetit për Shtyllat fleksibile me LED drita në maje për vendkalim të këmbësorëve si dokumente të veçanta, të cilat janë kërkauar që të dorëzohen me ofertë

3.Nuk e keni prezantuar dokument që tregon se Elektromodul është diler i autorizuar i prodhuesit ZIR, edhe pse është kërkuar autorizimi i dilerit apo prodhuesit.

4.Ju si Operatorë Ekonomik keni prezantuar. Dokumentin teknik ZIR i qasshëm përmend përputhje/certifikim me PN-EN 61508 SIL3 në materialin e produktit, por në paketën e deklaratave/certifikatave të qasshme nuk identifikuam një certifikatë SIL3 të kontrollerit. SIL3, përkatësisht të dëshohet certifikata përkatëse

Për të vlerësuar tenderin e juaj në mënyrë të duhur, ne kërkojmë që të siguroni sqarimin e tenderit të juaj si në vijim:
Të gjitha dokumentet duhen te jen para datës së hapjes **31.08.2026**.

1

Figura 2. B47 - kërkesa e AK-së për sqarime vetëm ndaj TRAFFIKS VA: EN50556/EN12675, EU DoC e bollardit, autorizimi ZIR-Elektromodul dhe certifikata SIL3.

Në përgjigje, TRAFFIKS VA deklaron se dokumentet "nuk janë ngarkuar me kohë" dhe i dorëzon në rivlerësim duke i cilësuar si dëshmuese dhe sqaruese. Ky pranim është relevant: çështja nuk është se dokumentet kanë qenë të ngarkuara por AK nuk i ka parë; operatori

pranon se dokumentet nuk janë ngarkuar në ofertën e tij. Prandaj, çdo dokument i ri duhet t'i nënshtrohet testit të nenit 38.3/38.4: a dëshmon një gjendje ekzistuese në kohën relevante dhe a është dhënë e njëjta mundësi edhe TSR-së?

TRAFFIKS VA SH.P.K.

Prishtinë, Datë: 13.10. 2026

Për: Komunën e Gjakovës

Lënda: Përgjigje ndaj kërkesës për informata për projektin "'Sinjalizimi rrugor në Qerim, Piskot, Brekoc, Blloku i ri, Has, Reka e Keqe, Reka e Mirë" -Nr. i prokurimit: 632-26-5866-2-1-1

Të nderuar,

Në përgjigje të kërkesës suaj për informata dhe sqarime, lidhur me dokumentacionin e ofertës së Operatorit Ekonomik TRAFFIKS VA SH.P.K., ju njoftojmë se i posedojmë dokumentet, certifikatat dhe dëshmitë përkatëse për të gjitha çështjet e ngritura në kërkesën tuaj.

Fillimisht, ju kërkojmë ndjesë për mosngarkimin me kohë të dokumentacionit përkatës në platformën e-prokurimit. Ky lëshim ka ndodhur gjatë procesit të ngarkimit të dokumenteve dhe nuk paraqet mungesë të dokumentacionit apo të kapaciteteve për përmbushjen e kërkesave teknike. Për këtë arsye, bashkëngjitur po ju dorëzojmë dokumentacionin përkatës të kërkuar në Letrën standarde të datës 12.10.2026

Theksojmë se dokumentacioni i dorëzuar ka karakter dëshmues dhe sqarues, pa ndryshuar përmbajtjen e ofertës financiare, teknike apo karakteristikat e produkteve të ofruara.

Duke u bazuar në dokumentacionin dhe sqarimet e paraqitura, kërkojmë që Autoriteti Kontraktues ti shqyrtojë ato në mënyrë objektive dhe në përputhje me dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik, si dhe të marrë vendim bazuar në përmbajtjen reale të ofertës dhe dëshmitë e dorëzuara.

Dokumente e kërkuara në formularin B47 Letër Standarde e kërkesës për informata do të jenë të bashkangjutra në email dhe te ngarkuara në platformen e-prokurimi.

Ju falënderojmë për bashkëpunimin dhe mbetemi në dispozicion për çdo sqarim shtesë eventual.

Me respekt,

TRAFFIKS VA SH.P.K.

Arbnora Kastrati Osmani

Adresa: Radovan Zogoviq, B1, nr.27, Prishtinë +383 48 19 19 19 info@traffiks-ks.com

Figura 3. Përgjigjja e TRAFFIKS VA: operatori pranon se dokumentet nuk janë ngarkuar me kohë dhe i paraqet në fazën e rivlerësimit.

4.1 Përmbledhje e dokumenteve të reja dhe statusi i tyre

Nr.	Çështja	Dokumenti i ri / gjendja	Vlerësimi i TSR-së
1	EN 50556 / EN 12675	Është sjellë një "Declaration of Conformity" ZIR ku standardet listohen; nuk është paraqitur certifikatë/atest i trupit certifikues për kontrollerin.	**NUK ËSHTË CERTIFIKATA/ATESTI I KËRKUAR; NUK DUHET TË KRIJOJË PËRPUTHSHMËRI PAS AFATIT**
2	SIL3	E njëjta deklaratë ZIR liston IEC 61508 SIL-3, por AK kërkoi "certifikatën SIL3"; dokumenti nuk ka numër certifikate/trup certifikues dhe deklaron se SWARCO ka bërë conformity assessment.	**NUK ËSHTË CERTIFIKATA SIL3; PRANIMI PA PROVË PARA-AFATIT KRIJON BAZË TË RE MATERIALE**
3	EU DoC bollard	Është sjellë DoC për SR-CITY-BALI-TSL-R, ndërsa modeli i ofertës së qasshme është SR-CITY-BALI-TL-R; DoC i ri nuk liston as IEC/EN60598, EN62493, IEC/EN62031.	MODEL TJETËR = NDRYSHIM MATERIAL; STANDARDET E KËRKUARA MUNGOJNË
4	ZIR → Elektromodul	Letër ZIR e datës 26.08.2026, e lëshuar pas publikimit të tenderit, konfirmon statusin e Elektromodul në atë datë;	DUHET PROVË OBJEKTIVE
5	Katalog i ri ZIR	Katalogu i ri dokumenton disa funksione, por jo 40 detektorë, 128 I/O, 2W, IP54, 230VAC ±10%/50Hz, -40/+60°C, degree of saturation, C-ITS/V2X dhe as zgjerim të qartë deri 64 signal groups.	PARAMETRA TË DETYRUESHËM MBETEN TË PADËSHMUAR

V. ANALIZA E DOKUMENTEVE TË SJELLA NGA TRAFFIKS VA PAS RIVLERËSIMIT

5.1 EN 50556 dhe EN 12675 - deklarata nuk zëvendëson certifikatat/atestet e kërkuara

Kërkesa e FDT-së	FDT kërkon EN 50556 - Road Traffic Signal Systems dhe EN 12675 - Traffic Signal Controllers - Functional Safety Requirements, nën rubrikën "Certifikatat e atesteve - të dorëzohen me ofertë".

Konstatimi / kërkesa e vetë AK-së	Në B47 AK vetë konstaton: “nuk keni prezantuar certifikatat EN 50556 ... dhe EN 12675 ... si dokumente të veçanta, të cilat janë kërkuar që të dorëzohen me ofertë”.
Dokumenti i sjellë nga TRAFFIKS VA pas rivlerësimit	TRAFFIKS ka sjellë një dokument njëfaqësh të titulluar “DECLARATION OF CONFORMITY” nga ZIR. Në të listohen EN50556:2018 dhe EN12675:2017, por dokumenti nuk është certifikatë/atest i lëshuar nga një trup certifikues dhe nuk përmban numër certifikate apo raport testimi. Në fund, ZIR deklaron se prodhuesi i kontrollerit, SWARCO Technology ApS, ka kryer conformity assessment – nuk ka autorizim te swarcos.
Kundërshtimi i TSR SH.P.K.	Nuk qëndron që kërkesa e AK-së është përmbushur vetëm sepse standardet janë shkruar në një deklaratë të re. B47 kërkon certifikatat si dokumente të veçanta. Për më tepër, dokumenti i ri deklaron se prodhuesi i kontrollerit është SWARCO Technology ApS, ndërsa oferta dhe autorizimet janë paraqitur në emër të ZIR. Nëse ky dokument përdoret për të krijuar pas afatit bazën e përputhshmërisë ose për të ndryshuar identitetin e prodhuesit/produktit, kemi ndryshim material dhe jo sqarim.
Relevanca ligjore / procedurale	Neni 59.2 LPP dhe neni 38.2 i Rregullores ndalojnë ndryshimin e një aspekti material. Neni 38.3 lejon dokumentin e munguar vetëm kur ai pasqyron objektivisht gjendjen ekzistuese para 31.08.2026; neni 38.4 kërkon që mundësia për sqarim të jepet në kushte të njëjta për të gjithë OE.
Kërkesa ndaj AK-së	AK të konstatojë se B47 pika 1 nuk është kuruar vetëm me një Declaration of Conformity. Nëse dokumenti pranohet si provë ekuivalente.



DECLARATION OF CONFORMITY

ZIR - Systemy Sterowania Ruchem Sp. z o.o., with its registered office in Bytom, Poland, declares under its sole responsibility that the product referred to below has been manufactured in accordance with the following standards:

1. Concerns:
   Product name: **ITC-3 SIL3 Traffic Signal Controller**
   Type no.: **CAB, RAC - 24/40, 6/16, 12/0**
   Trade name: **ITC-3PL**
2. Purpose and scope of use of the product:
   Control of signal groups according to the supplied traffic signal control program, ensuring the safety of vehicular and pedestrian traffic.
3. Reference documents:

Directives:	2014/53/EU	EU Radio Equipment Directive (RED)
	2014/35/EU	Low Voltage Directive
	2011/65/EU	RoHS Directive
Standards:		
EMC:		
	EN 50293:2012	Road traffic signal systems, Electromagnetic compatibility
	EN 50121-4:2016 + A1	Railway applications, Electromagnetic compatibility
	EN 300 330 V2.1.1:2017	Short Range Devices, Radio and inductive loop
	EN 301 489-3 V2.1.1:2019	Short-Range Devices (SRD) 9 kHz to 246 GHz
	IEC 61000-3-2:2019	AC-mains harmonic current emissions
	IEC 61000-3-3:2013	AC-mains voltage fluctuations and flicker
LVD:		
	EN 50556:2018	Road traffic signal systems
	EN 62368-1:2020	Audio-/video, information and communication technology
RoHS:		
	EN 50581:2012	Electrical and electronic products, restriction of hazardous substances
Traffic:		
	EN 50556:2018	Road traffic signal systems
	EN 12675:2017	Traffic signal controllers - Functional safety requirements
Functional safety:		
	IEC 61508:2008	Functional safety, electronic safety related systems, SIL-3
	VDE 0832-110:2019	Road traffic signal systems: Technical requirements
	VDE 0832-500:2016	Road Traffic Signal Systems: Safety-related Software

ZIR - Systemy Sterowania Ruchem hereby declares that the manufacturer of the controller, SWARCO Technology ApS, Denmark, has carried out conformity assessment of the product against the above-mentioned standards, and that the product may bear the CE marking (Conformite Europeenne).

ZIR Systemy Sterowania Ruchem (sp. z o.o.)
Marcin Mazur
Dyrektor Generalny/CEO

ZIR – Systemy Sterowania Ruchem Sp z o.o.
ul. Przemysłowa 5, 41-902 Bytom, Poland
District Court Katowice-Wschód in Katowice
VIII Commercial Division of the National Court Register
Share capital: PLN 200,000.00 paid up in full

KRS: 0001106190
Tax ID (NIP) 6262508926
Business Registry No. (REGON) 276269573

www.grupazir.pl

Page 1 of 1

Figura 4. Dokumenti i ri ZIR: liston EN50556, EN12675 dhe IEC61508 SIL-3, por është "Declaration of Conformity", jo certifikatë/atest i trupit certifikues.

5.2 SIL3 - B47 kërkon certifikatë, ndërsa është sjellë vetëm deklaratë

Kërkesa e FDT-së	FDT kërkon "Niveli i integruar i sigurisë SIL3". Në vlerësimin e parë, TSR u eliminua pikërisht për këtë pikë.
Konstatimi / kërkesa e vetë AK-së	B47 pika 4 është e qartë: dokumenti teknik ZIR përmend PN-EN 61508 SIL3, por në paketën e deklaratave/certifikatave "nuk identifikuam një certifikatë SIL3 të kontrollerit"; AK kërkon që "SIL3, përkatësisht të dëshmohet certifikata përkatëse".
Dokumenti i sjellë nga TRAFFIKS VA pas rivlerësimit	Në përgjigje, TRAFFIKS ka sjellë po të njëjtën "Declaration of Conformity" ku në rreshtin Functional safety shkruan IEC 61508:2008 ... SIL-3. Dokumenti **nuk identifikon** trup certifikues, numër certifikate, fushë/certification scope ose raport të pavarur SIL3. Madje dokumenti deklaron se SWARCO Technology ApS ka kryer conformity assessment.
Kundërshtimi i TSR SH.P.K.	AK kërkoi certifikatën SIL3. Një deklaratë e re që vetëm liston IEC61508/SIL-3 nuk është e njëjta provë. Nëse


	certifikimi/prova nuk ka ekzistuar para 31.08.2026, dokumenti i ri krijon pas afatit një element thelbësor të përputhshmërisë dhe përbën plotësim material. Në të kundërt, nëse AK e konsideron këtë vetëm sqarim, TSR duhej të merrte të njëjtën mundësi për VEGA.
Relevanca ligjore / procedurale	Neni 7 LPP; neni 59.2 LPP; nenet 38.2-38.4 të Rregullores. Sqarimi nuk mund të krijojë një kusht material që mungonte dhe duhet të ofrohet në kushte të njëjta për të gjithë operatorët.
Kërkesa ndaj AK-së	AK të mos e konsiderojë deklaratën si 'certifikatë SIL3'.

5.3 EU Declaration of Conformity e bollardit - modeli i gabuar dhe standardet e gabuara

Kërkesa e FDT-së	FDT kërkon për bollardin EU Declaration/Declaration of Conformity dhe përputhje me IEC 60598-2-13, IEC 60598-1, EN 60598-2-13/EN IEC 60598-1, IEC/EN 62493 dhe IEC/EN 62031. Dokumentet kërkohen me ofertë.
Konstatimi / kërkesa e vetë AK-së	Në B47 pika 2, AK konstaton se TRAFFIKS "nuk keni prezantuar EU deklarimin e konformitetit për Shtyllat fleksibile me LED drita në maje për vendkalim të këmbësorëve si dokument të veçantë".
Dokumenti i sjellë nga TRAFFIKS VA pas rivlerësimit	Dokumenti i ri është EU Declaration of Conformity për modelin SR-CITY-BALI-TSL-R - "Flexible Bollard with Top Solar Light". Në ofertën e qasshme, modeli teknik i analizuar/ofertuar është SR-CITY-BALI-TL-R. Për më tepër, DoC i ri liston vetëm EMC 2014/30/EU dhe standardet EN50293, EN55022, EN61000-4-2, EN61000-4-3 dhe EN61000-4-8. Nuk liston asnjërin nga standardet IEC/EN60598, EN62493 dhe IEC/EN62031 që FDT kërkon për këtë produkt.
Kundërshtimi i TSR SH.P.K.	Kjo pikë nuk është kuruar dhe këtu kemi ndryshim material të identitetit të produktit. Oferta gjate qasjes identifikon SR-CITY-BALI-TL-R, ndërsa dokumenti i sjellë pas B47 është për SR-CITY-BALI-TSL-R - model tjetër. Një DoC për model tjetër nuk sqaron ofertën; ai zëvendëson produktin që duhet të provohet. Edhe për TSL-R, DoC nuk liston IEC/EN60598, EN62493 dhe IEC/EN62031 të kërkuara.
Relevanca ligjore / procedurale	Neni 59.2 LPP dhe neni 38.2 ndalojnë ndryshimin material; neni 38.3 lejon vetëm dokument që pasqyron gjendjen e të njëjtit produkt para 31.08.2026. Ndërrimi TL-R → TSL-R nuk është sqarim.
Kërkesa ndaj AK-së	AK të konstatojë se B47 pika 2 nuk është përmbushur dhe se DoC i TSL-R nuk mund të përdoret për TL-R.



Modeli në ofertën e qasshme: SR-CITY-BALI-TL-R.



EU Declaration of Conformity (DoC)

We

Company name:	SERNIS – Soluções Tecnológicas, LDA
Postal address:	Quinta do Carreiro, Lote 9/14, Frossos
Postcode and City:	4700-154 Braga
Telephone number:	+351 253 300 440
E-Mail address:	sernis@sernis.com

declare that the DoC is issued under our sole responsibility and belongs to the following product:

Apparatus model/Product:	SR-CITY-BALI-TSL-R
Type:	Flexible Bollard with Top Solar Light

Object of the declaration

The object of the declaration described above is in conformity with the relevant Union harmonisation legislation:

Electromagnetic Compatibility Directive (EMC) 2014/30/EU

The following harmonised standards and technical specifications have been applied:

Title:	Date of standard/specification
EN 50293	
EN 55022	2006 + A1:2007
EN 61000-4-2	1995 + A1:1998 + A2:2001
EN 61000-4-3	2006
EN 61000-4-8	1993 + A1:2001

Signed for and on behalf of:

Braga, 2026-01-27

Eng. Fernando Afonso (General Director) SERNIS - Formação e Soluções Tecnológicas, Lda. A GERÊNCIA

Dokumenti i ri: EU DoC për SR-CITY-BALI-TSL-R, model tjetër dhe standarde EMC, jo standardet e FDT-së.

5.4 Autorizimi ZIR → Elektromodul - letra është krijuar pas shpalljes së tenderit.

Kërkesa e FDT-së	FDT lejon autorizim nga prodhuesi ose dileri i autorizuar. Nëse autorizimi lëshohet nga dileri/përfaqësuesi, statusi i tij duhet të jetë i verifikueshëm.
Konstatimi / kërkesa e vetë AK-së	Në B47 pika 3, AK konstaton se nuk ishte prezantuar dokument që tregon se Elektromodul është diler i autorizuar i ZIR.
Dokumenti i sjellë nga TRAFFIKS VA pas rivlerësimit	ZIR ka sjellë një letër të datës 26.08.2026 ku konfirmon se Elektromodul-Promet është "authorized regional representative and business partner" për produktet ZIR, përfshirë kontrollerë dhe semaforë.
Kundërshtimi i TSR SH.P.K.	Fakti se letra është e datës 26.08.2026 tregon se vetë ky dokument nuk ka ekzistuar në momentin e publikimit të tenderit dhe eshte ne kundershtim me legjislacionin.
Relevanca ligjore / procedurale	Neni 38.3 kërkon që dokumenti i munguar të pasqyrojë objektivisht gjendjen ekzistuese para 31.08.2026; neni 38.2 ndalon ndryshimin material. Neni 38.4 kërkon trajtim të njëjtë për të gjithë OE. Data 26.08.2026 është pas publikimit të tenderit.
Kërkesa ndaj AK-së	AK të kërkojë provë objektive të para-afatit për ekzistencën e marrëdhënies (p.sh. autorizim, kontratë ose korrespondencë e

	mëparshme). Vetëm letra e datës 26.08.2026 nuk përcakton kur ka filluar autorizimi dhe eshte pas dates se shpalljes se tenderit.

ZIR | Systemy Sterowania Ruchem

AUTHORIZATION / CONFIRMATION OF REPRESENTATION

We, ZIR – Systemy Sterowania Ruchem sp. z o.o., hereby confirm that ELEKTROMODUL-PROMET d.o.o., Andrije Hebranga 7, 31000 Osijek, Croatia, is our authorized regional representative and business partner for ZIR products and solutions.

ELEKTROMODUL-PROMET d.o.o. is authorized to represent and promote ZIR – Systemy Sterowania Ruchem sp. z o.o. and to offer, supply, install, and provide technical support for ZIR products and equipment.

This authorization covers ZIR traffic management and road traffic signalization equipment, including traffic lights, traffic controllers, illuminated signs, accessories, complementary components, and other related equipment and software solutions.

ELEKTROMODUL-PROMET d.o.o. is also authorized to cooperate with customers, local partners, contractors, public authorities, and other relevant entities in connection with the supply and implementation of ZIR products and solutions.

We confirm that ELEKTROMODUL-PROMET d.o.o. is entitled to use this authorization as evidence of its authorized business and representative relationship with ZIR – Systemy Sterowania Ruchem sp. z o.o.

This authorization is issued upon request and remains valid until revoked in writing by ZIR – Systemy Sterowania Ruchem sp. z o.o.

For and on behalf of
ZIR – Systemy Sterowania Ruchem sp. z o.o.

Name: MARCIN MAZUR
Position: CEO

Signature:

ZIR | Systemy Sterowania Ruchem sp. z o.o.
Marcin Mazur
Dyrektor Generalny/CEO

ZIR | Systemy Sterowania Ruchem sp. z o.o.
41-902 Bytom, ul. Przemysłowa 5
NIP 6262508926 REGON 276269573

Company Stamp:

Date: 2026-08-26

ZIR – Systemy Sterowania Ruchem Sp z o.o.
ul. Przemysłowa 5, 41-902 Bytom
Sąd Rejonowy Katowice-Wschód w Katowicach
VIII Wydział Gospodarczy Krajowego Rejestru Sądowego
Kapitał zakładowy : 200 000,00 zł opłacony w całości

KRS 0000116630
NIP 6262508926
REGON 276269573

www.grupazir.pl

Strona 1 z 1

Figura 5. Letra ZIR për Elektromodul është e datës 26.08.2026, pra pas publikimit të tenderit. Ajo konfirmon statusin në atë datë, por nuk përcakton se kur ka filluar marrëdhënia e autorizimit.

5.5 Katalogu i ri ZIR - edhe pas sqarimit mbeten parametra të detyrueshëm të padëshmuar

Kërkesa e FDT-së	FDT kërkon, ndër të tjera: minimum 12 signal groups me zgjerim deri 64; deri 40 detektorë; 128 digital I/O; IP54; 230VAC ±10%, 50Hz; -40/+60°C; minimum output-load detection 2W; optimizim green times/cycle/degree of saturation; Ethernet/GPRS/3G/4G; prioritet PT/emergency; EN50556/EN12675; SIL3; C-ITS/V2X.
Konstatimi / kërkesa e vetë AK-së	B47 nuk kërkon sqarim për të gjitha këto pika, ndonëse ato ishin ngritur në kërkesën tonë paraprake. Në rivlerësim është sjellë një katalog i ri ZIR për kontrollerin.
Dokumenti i sjellë nga TRAFFIKS VA pas rivlerësimit	Faqja 7 e katalogut të ri dokumenton ITC-3PL/6, /12 dhe /24; për /12 shkruan “up to 36 signal groups”, për /24 “up to 72 output signals, expandable”, dhe maksimum “192 output signals with extension module”. Dokumenton touchscreen, adaptive local control/coordination dhe disa safety features. Por nuk identifikon 40 detektorë, 128 digital I/O, IP54, 230VAC ±10%/50Hz, -40/+60°C, minimum 2W, kalkulimin e degree of saturation, C-ITS/V2X dhe as nuk deklaron qartë zgjerim deri në 64 signal groups.
Kundërshtimi i TSR SH.P.K.	Output signals nuk janë automatikisht 'signal groups' dhe nuk mund të barazohen pa deklarim teknik të prodhuesit. Mbi të gjitha, FDT ka kërkuar që katalogu i dorëzuar me ofertë të krahasohet me secilin parametër të detyrueshëm. Një katalog i ri pas afatit mund të qartësojë vetëm karakteristika paraekzistuese të të njëjtit produkt; nuk mund të shtojë pas afatit parametra që mungonin në ofertën origjinale.
Relevanca ligjore / procedurale	Neni 59.2/59.4 LPP; nenet 38.2-38.4 të Rregullores. Nëse katalogu i ri përdoret për të krijuar përputhshmëri teknike që nuk ishte e dëshmuar para 31.08.2026, ndryshohet baza materiale e tenderit.
Kërkesa ndaj AK-së	AK të identifikojë për secilin parametër dokumentin e ofertës origjinale që e provon. Nëse përputhshmëria mund të demonstrohet vetëm me katalogun e ri, kjo nuk duhet të pranohet si sqarim, por si plotësim material pas afatit.


ROAD SAFETY PRODUCTS

CONTROLLERS

ITC–3PL

Traffic light controller designed for ease of service and flexibility of configuration — from a pedestrian crossing to a full ITS corridor.

ITC–3PL / 6
up to 18 output signals

ITC–3PL / 12
up to 36 signal groups

ITC–3PL / 24
up to 72 output signals, expandable

192
maximum output signals with extension module

CONTROL & INTEGRATION

- Highly scalable — from small pedestrian crossings to large intersections connected to ITS systems
- Touch screen for intuitive changes to signalling programs and analysis of operation, with three access levels
- Simple, intuitive programming using the ITC-PC tool
- Adaptive local control (SMART INTERSECTION)
- Adaptive coordination (SMART CORRIDOR) with dynamic green wave
- X-Link protocol for data exchange with other controllers; ModBus supported
- Cooperates with ZIR24, Utopia/Spot, Omnivue, EC-Trak and Scats
- Supports up to four independent intersections

Cabinets available in several sizes and configurations.

SAFETY FEATURES

- Configuration verification by checksum
- Hardware watchdog monitoring CPU operation
- Non-volatile memory with password protection
- Battery-backed real-time clock
- Supply voltage monitoring
- Collision matrix and green time supervision
- Two-way voltage and current measurement of output channels

grupazir.pl/en/produkty/bezpieczenstwo-ruchu-drogowego/sterowniki

07

Figura 6. Katalogu i ri ZIR, faqja 7: dokumenton disa funksione të ITC-3PL, por jo të gjitha kërkesat numerike/funksionale të FDT-së.

5.6 Kufiri ndërmjet sqarimit dhe ndryshimit material të tenderit

Testi juridik mbështetet vetëm në përmbajtjen e dokumenteve dhe në kohën kur ka ekzistuar gjendja që ato pretendojnë të provojnë. Sipas nenit 38.2, nuk lejohet asnjë ndryshim i çmimit ose i një kushti/aspekti material të tenderit; sipas nenit 38.3, dokumenti i munguar mund të merret vetëm kur pasqyron objektivisht një gjendje që ka ekzistuar para 31.08.2026.

Dokumenti / situata	Analiza e materialitetit
ZIR Declaration of Conformity - EN50556/EN12675/SIL3	Nuk është certifikata/atesti i kërkuar; dokumenti i ri deklaron edhe SWARCO si prodhues. Pa provë objektive se e njëjta bazë certifikimi ekzistonte para 31.08.2026, pranimi krijon bazë të re të përputhshmërisë pas afatit.
SERNIS DoC SR-CITY-BALI-TSL-R	Oferta e qasshme identifikon TL-R, ndërsa dokumenti i ri është për TSL-R. Zëvendësimi i modelit për të plotësuar kërkesën është ndryshim material, jo sqarim.
ZIR → Elektromodul, letër 26.08.2026	Dokumenti është lëshuar pas publikimit të tenderit dhe nuk tregon kur ka filluar marrëdhënia. Mund të pranohet vetëm nëse provohet objektivisht se marrëdhënia ekzistonte para 31.08.2026.
Katalogu i ri ZIR	Nuk mund të përdoret për të shtuar pas afatit parametra teknikë që FDT kërkonte të provoheshin nga katalogu i ofertës; vetëm mund të qartësojë karakteristika paraekzistuese të të njëjtit produkt.


Për këtë arsye, sqarimi bëhet ndryshim material kur dokumenti i ri: (a) zëvendëson modelin e ofertuar me model tjetër; (b) sjell për herë të parë një bazë të re të përputhshmërisë/certifikimit që nuk mund të provohet se ekzistonte para afatit; (c) ndryshon ose mjegullon identitetin e prodhuesit/produktit; ose (d) plotëson pas afatit një karakteristikë teknike që FDT kërkonte të provohej nga katalogu i dorëzuar me ofertë. Pikërisht këto elemente shfaqen në dokumentet plotësuese të TRAFFIKS VA dhe duhet të analizohen si çështje materialiteti, jo të pranohen automatikisht si 'sqarim'.

VI. MANGËSITË E TRAFFIKS VA NGA KËRKESA I QË NUK JANË TRAJTUAR NË B47

Rivlerësimi nuk mund të kufizohet vetëm në katër pikat që AK zgjodhi t'i sqarojë. Kërkesa jonë paraprake kishte ngritur edhe mospërputhje të tjera teknike të drejtpërdrejta. Këto çështje mbeten relevante dhe duhet të adresohen me vendim të arsyetuar pikë për pikë.

6.1 ZIRSlim - certifikata e paplotë për intensitet dhe Phantom Class 5

FDT kërkon >400 cd për LED 300 mm, >200 cd për 210/200 mm dhe certifikatë që e dëshmon këtë, si dhe Phantom Class 5 me certifikatë EN12368. Dokumenti "ZIRSlim-Certifikatat.pdf" i qasshëm në ofertë kishte vetëm faqet 1/23 dhe 2/23. Në faqen 2, për luminous intensity dhe maximum phantom signal shkruhet "See Table(s) 1 and Table(s) 2 for details", por këto tabela nuk ishin pjesë e dokumentit të qasshëm. Nëse 23 faqet/tabelat nuk kanë qenë të ngarkuara në ofertën origjinale, provat për intensitetin dhe Phantom Class 5 nuk janë dorëzuar në formën që FDT kërkon "me ofertë".



Certificate
of constancy of performance

Number: 1304-CPR-0049

Additional information:

Type reference:	ZIRslim X.YYY; where "X" means 1 or 2 or 3 aspects; "YYY" means optical unit diameter 200 mm or 300 mm
Size:	200 mm or 300 mm
Impact resistance:	Class IR3, Class IR2, Class IR1
Environmental parameters:	
- Temperature range:	Class A, Class B, Class C
- Ingress protection:	IP 55, IP 54 (enclosures provided with gasket)
Luminous intensity:	See Table(s) 1 and Table(s) 2 for details
Distribution of luminous intensity:	See Table(s) 1 and Table(s) 2 for details
Luminance uniformity:	≥ 10 (for Types E, W and M) ≥ 15 (for Type N)
Maximum phantom signal:	See Table(s) 1 and Table(s) 2 for details
Colours of signal lights:	All colours within the colour boundaries
Signal head enclosure:	ZIRslim 200 mm signal head enclosure in 1, 2 or 3 aspect and ZIRslim 300 mm signal head enclosure in 1, 2 or 3 aspect. Other combinations are possible.

Remarks:
This Certificate of constancy of performance 1304-CPR-0049 supersedes previously issued Certificate of constancy of performance 1304-CPR-0018 from 2014-04-29.

Date: 2010 02 10 **Authorized signature:** Bojan Počavar

SIQ Ljubljana, Tržaška cesta 2, SI-1000 Ljubljana, Slovenia
T +386 1 4778 100, F +386 1 4778 444, info@siq.si, www.siq.si

CPR DN003E-03

Page 2 (23)

ZIRSlim - faqja 1/23 e certifikatës së qasshme.



Certificate
of constancy of performance

Number: 1304-CPR-0049

Additional information:

Type reference:	ZIRslim X.YYY; where "X" means 1 or 2 or 3 aspects; "YYY" means optical unit diameter 200 mm or 300 mm
Size:	200 mm or 300 mm
Impact resistance:	Class IR3, Class IR2, Class IR1
Environmental parameters:	
- Temperature range:	Class A, Class B, Class C
- Ingress protection:	IP 55, IP 54 (enclosures provided with gasket)
Luminous intensity:	See Table(s) 1 and Table(s) 2 for details
Distribution of luminous intensity:	See Table(s) 1 and Table(s) 2 for details
Luminance uniformity:	≥ 10 (for Types E, W and M) ≥ 15 (for Type N)
Maximum phantom signal:	See Table(s) 1 and Table(s) 2 for details
Colours of signal lights:	All colours within the colour boundaries
Signal head enclosure:	ZIRslim 200 mm signal head enclosure in 1, 2 or 3 aspect and ZIRslim 300 mm signal head enclosure in 1, 2 or 3 aspect. Other combinations are possible.

Remarks:
This Certificate of constancy of performance 1304-CPR-0049 supersedes previously issued Certificate of constancy of performance 1304-CPR-0018 from 2014-04-29.

ZIRSlim - faqja 2/23: intensiteti dhe phantom signal i referohen Tabelave 1 dhe 2 që nuk ishin në PDF-në 2-faqëshe.

6.2 ZIRSlim - 210 mm nominal nuk dëshmohet në certifikatën e qasshme

FDT kërkon 200 mm, 210 mm dhe 300 mm. Certifikata ZIRSlim e qasshme identifikon nominal size 200 mm dhe 300 mm. 210 mm nominal nuk identifikohet. Nëse AK e ka

interpretuar kërkesën në mënyrë strikte ndaj TSR-së, i njëjti standard duhet të vlejë për TRAFFIKS. Dimensioni fizik i një moduli nuk është automatikisht i njëjtë me klasifikimin nominal/certifikimin e produktit.

6.3 ZIRSlim - temperatura +65°C dhe krahasimi direkt me TRAFLED

FDT kërkon A/B/C sipas EN12368 dhe, veçmas, -40°C deri +65°C. ZIRSlim në dokumentet e qasshme paraqet klasat A/B/C, por nuk kemi identifikuar provë të +65°C. TSR u eliminua sepse TRAFLED deklaron -40/+60°C, megjithëse TRAFLED është i certifikuar A/B/C sipas të njëjtit EN12368. Nëse A/B/C është konsideruar i mjaftueshëm për ZIRSlim pa provë +65°C, refuzimi i TRAFLED për të njëjtën situatë është trajtim i pabarabartë.

Përshkrimi Teknik	
Materiali	Polycarbonate UV - Stabilizuar
Diametri	200 mm / 210 mm / 300mm,
Rezistenca ndaj goditjeve	class IR 3 sipas EN 12368
Temperature class	A, B, and C in compliance with EN 12368
Ngjyrat e Laternave	Tre standarde (Kuq, Verdhe, Gjelbër)
Laterna	200 mm, 210mm and 300mm
Temperatura punuese	-40°C +65°C
Tensioni punues	230 VAC +/- 10%, 50 Hz

Kërkesa e FDT-së: A/B/C dhe, veçmas, -40°C/+65°C.

Optical parameters	Meeting the requirements of EN 12368 and local standards
EMC	According to EN 50293
Temperature range	Class A, B, C (-40° C to +60° C)
Protection class	II protection class; according to EN 61140
Tightness	Class IP 65; according to EN 60529
Impact resistance	Class IR3; according to EN 60598-1
Material	Polycarbonate
Weight	100 mm: <0,25 kg 200 mm: <0,9 kg 300 mm: <1,5 kg
Cable	2 x 0,75 mm²; 1 m
Dimensions (including lens)	100 mm: Ø 108 x 72 mm 200 mm: Ø 210 x 117 mm 300 mm: Ø 300 x 149 mm

Dokumentacioni ZIR i qasshëm: klasat A/B/C; +65°C nuk identifikohet.

6.4 SR-CROSSLED-L - “Linear 110°” kundrejt kërkesës “Matrix 110°”

FDT kërkon shprehimisht “LED konfigurimi: Matrix 110°”. Katalogu SR-CROSSLED-L i dorëzuar nga TRAFFIKS shkruan “LEDs Configuration: Linear 110°” dhe “Linear with 110° viewing angle”. Kjo është mospërputhje tekstuale e drejtpërdrejtë, jo thjesht mungesë prove. Ose “Matrix” është kërkesë minimale dhe produkti nuk përputhet, ose AK e konsideron “Linear 110°” funksionalisht ekuivalent - në të cilin rast ekuivalenca duhet të aplikohet po njësoj ndaj Ekaldes/TSR.




Figura 7. SR-CROSSLED-L Technical Features: "Linear with 110° viewing angle"; FDT kërkon "Matrix 110°".

6.5 SR-CROSSLED-L - steady light / pulsing mode

FDT kërkon dritë konstante dhe mundësi me dritë pulsive. Katalogu i qasshëm identifikon "Operation Mode: Steady Light" dhe vetëm në mënyrë të përgjithshme thotë se "other modes" janë të mundshme me external controller. Nëse kjo është pranuar si e mjaftueshme

për TRAFFIKS, atëherë formulimi “nuk tregohet” nuk mund të përdoret si eliminues ndaj TSR për karakteristika që mund të sqarohen me prodhuesin.




Figura 8. Katalogu SR-CROSSLED-L: Linear 110° dhe Operation Mode: Steady Light.

6.6 Bollardi - modeli TL-R / TSL-R dhe ndalimi i transferimit të karakteristikave

Oferta e qasshme përmban modele të ndryshme SR-CITY-BALI-TL-R dhe SR-CITY-BALI-TSL-R. Në kërkesën e parë kemi theksuar se karakteristikat e njërit model nuk mund të transferohen automatikisht te modeli tjetër. Dokumenti i ri i sqarimit e forcon këtë pretendim: EU DoC është lëshuar pikërisht për TSL-R, ndërsa katalogu i modelit të ofertuar

që kemi identifikuar është TL-R. Sqarimi duhet të provojë produktin e ofertuar, jo të zëvendësojë modelin me një variant tjetër.

VII. STANDARDI I DYFISHTË - PSE SQARIMI ËSHTË DHËNË VETËM TRAFFIKS VA

Çështja më e rëndësishme procedurale është përdorimi selektiv i mekanizmit të sqarimit. Pas kthimit në rivlerësim, AK i ka dërguar B47 vetëm TRAFFIKS VA për mungesa që prekën vetë përgjegjshmërinë e ofertës: certifikata EN50556/EN12675, certifikata SIL3, EU DoC e bollardit dhe zinxhiri i autorizimit ZIR-Elektromodul. TSR-së, ndërkaq, nuk iu kërkua asnjë sqarim analog para eliminimit për SIL3, deklaratat e konformitetit Ekaldes apo karakteristikat tender-specific të produkteve tona. Neni 38.4 është eksplicit se mundësia për informacion shtesë duhet të sigurohet në kushte të njëjta për të gjithë operatorët ekonomikë. Nuk është trajtim i barabartë që një ofertë të eliminohet menjëherë për paqartësi dokumentare, ndërsa ofertës tjetër t'i jepet mundësi pasuese për të ndërtuar dokumentacionin që i mungonte.

Çështja	TSR SH.P.K.	TRAFFIKS VA	Standardi i dyfishtë
SIL3	TSR u eliminua pa sqarim shtesë, megjithëse VEGA ka EN12675/EN50556 dhe arkitekturë fail-safe të dokumentuar.	AK i kërkoi TRAFFIKS pas afatit certifikatën SIL3 dhe i lejoi të sjellë dokument të ri.	TSR u eliminua pa B47; TRAFFIKS mori B47 për të njëjtin element thelbësor dhe solli dokument të ri. Nëse ky plotësim lejohet, mosdhënia e të njëjtës mundësi TSR-së shkel nenin 38.4; nëse dokumenti krijon SIL3/provën pas afatit, kemi ndryshim material.
EN50556 / EN12675	TSR kishte dokumente/DoP dhe prova sektoriale të VEGA-s.	TRAFFIKS nuk i kishte certifikatat e kërkuara me ofertë; AK i kërkoi pas afatit.	TSR kishte prova sektoriale; TRAFFIKS nuk i kishte certifikatat me ofertë dhe iu lejua plotësim. Standardi dokumentar nuk mund të jetë strikt për TSR dhe fleksibil për TRAFFIKS.
EU DoC bollard	Ekaldes/TSR u eliminua për mungesë/format të DoC pa kërkesë për sqarim.	TRAFFIKS nuk kishte EU DoC të bollardit; AK i kërkoi pas afatit. Dokumenti i ri është madje për model tjetër dhe nuk përmban standardet e FDT-së.	TSR u eliminua pa sqarim për formën/dokumentin; TRAFFIKS mori B47 dhe madje solli DoC për model tjetër. Kjo është jo vetëm pabarazi procedurale, por edhe rrezik i

			ndryshimit material të produktit.
Karakteristika që "nuk tregohen"	Te Ekaldes, "nuk tregohet në foto/katalog" u trajtua si "nuk plotëson".	Te ZIR/SERNIS, disa parametra nuk tregohen ose janë të kundërt (Linear vs Matrix), por AK kërkon/lejoi sqarim vetëm për disa prej tyre.	Mungesa e provës nuk mund të ketë peshë të ndryshme sipas operatorit.
Temperatura semaforike	TRAFLED -40/+60°C dhe A/B/C u refuzua.	ZIRSlim A/B/C, pa provë +65°C në dokumentet e qasshme, nuk u trajtua njësoj.	Ose +65°C është absolut për të dy, ose ekuivalenca EN12368 A/B/C shqyrtohet për të dy.

Pasoja procedurale

Nëse AK mendon se dokumentet e TRAFFIKS janë vetëm sqarime të një gjendjeje ekzistuese dhe jo ndryshim i ofertës, atëherë është e detyruar që të aplikojë të njëjtën mundësi ndaj TSR për çështje të së njëjtës natyrë. Nëse, në anën tjetër, çështjet e TSR janë konsideruar materiale dhe të pakurueshme, atëherë mungesa e certifikatave/DoC të TRAFFIKS të kërkuara "me ofertë" duhet të ketë të njëjtën pasojë.

VIII. ARSYETIMET E TSR SH.P.K. NGA KËRKESA PARAPRAKE - MBETEN TË PLOTËFUQISHME

8.1 SCAE VEGA - functional safety dhe kërkesa SIL3

Nuk qëndron konstatimi se VEGA nuk plotëson kërkesën e sigurisë vetëm sepse dokumentacioni nuk mban etiketën formale "SIL3". FDT vetë kërkon verifikim software, monitorim programi, memorie të mbrojtur, power monitoring, independent conflict monitoring dhe output monitoring. VEGA i realizon këto funksione me arkitekturë redundante/diversified HW/SW, procesor të dedikuar për conflict monitoring, sensor redundant për green output, current/voltage monitoring, hardware/software watchdog, configuration/data checks, redundant output congruence, Intergreen Matrix enforcement dhe safe/emergency state. DoP e VEGA-s identifikon EN50556 dhe EN12675 - standardin sektorial për functional safety të traffic signal controllers.

Pika vendimtare pas rivlerësimit është kjo: TSR u eliminua pa B47 për SIL3, ndërsa TRAFFIKS u lejua të sjellë pas afatit një dokument të ri që liston IEC61508/SIL3 dhe EN12675/EN50556. Nëse dokumenti i ri vetëm provon një gjendje të paraekzistuar, TRAFFIKS duhet të dëshmojë objektivisht se kjo provë/certifikim ekzistonte para 31.08.2026. Nëse nuk mund ta dëshmojë këtë, pranimi i dokumentit krijon pas afatit bazën e përputhshmërisë dhe përbën plotësim material. Në çdo rast, neni 38.4 kërkon që TSR-së t'i ishte dhënë e njëjta mundësi për sqarim të VEGA-s.

SECURITY

VEGA security functions are based on a redundant control circuit system structured on diversified hardware/software module

The system is managed by several processors and hardware circuitry as follows:

- Analogue sensors to measure the voltage applied to the traffic light driven by each controller output (redundant sensor on green lamp).
- Analogue sensors to measure the current flowing into the traffic light driven by each controller outputs.
- Indipendent hardware and software conflict monitoring security function for green and red output performed by a specific processor.
- Each I/O card processors performing:
  - Light diagram congruence control.
  - Current check.
  - Automatic lamp monitoring that notifies lamp failure of any colour and any signal group.
- Hardware and software watch dog.
- CPU processors performing:
  - Programmed data check.
  - Hardware configuration check.
  - Redundant congruence control of output status.
  - Filter action on logic command to respect the Intergreen matrix.
  - Time out control.
  - Main supply voltage measuring and control.
  - Site ID protection.



The occurring of the above said security control will put the controller into an emergency condition where all amber outputs can be flashing.

SOFTWARE CONFIGURATION

SCAE VEGA - SECURITY: redundant/diversified HW/SW, conflict monitoring, watchdog, output congruence, Intergreen dhe safe state.

the construction product according to Annex V of UE Reg. n°305/2011

Laboratorio notificato e numero di accreditamento *Notified product certification body & number*	EUROFINS Modulo Uno - n° 0085

Ha rilasciato Certificato di conformità alle norme tecniche dichiarate:
Issued certificate of Conformity in accordance with the declared technical standards:
EN50556-2011, EN 12675-2000, EN 50293-2012

PRESTAZIONE DICHIARATA
DECLARED PERFORMANCE

Caratteristiche essenziali ***Essential characteristics***	**Prestazioni** ***Performances***	**Norma Tecnica** ***Harmonised technical standard***
Alimentazione *Power supply*	230Vac +15% -20% // 50Hz +/-5%	EN50556-2011
Contenitore *Housing*	Classi: V2 (IP55) // IK07	EN50556-2011
Sicurezza dei segnali *Safety of signals*	Classe AF5	EN50556-2011
Controlli *Controls*	Classe AG4 (< 300mS)	EN50556-2011
Sicurezza funzionale *Operating safety*	Conformità alla norma *In accordance with standard*	EN 12675-2000
Compatibilità EMC *EMC compatibility*	Conformità alla norma *In accordance with standard*	EN 50293-2012

Si rilascia la presente dichiarazione di prestazione sotto la responsabilità esclusiva del produttore

This declaration of performance is issued under the sole responsibility of the manufacturer

VEGA DoP: EUROFINS; EN50556/EN12675; Operating Safety sipas EN12675.

8.2 SCAE TRAFLED - IP65: arsyeja fillestare e AK-së është faktikisht e gabuar

FDT kërkon “LED moduli - IP65 protection”. AK ka përdorur IP55 të signal head/housing për të refuzuar TRAFLED. Dokumentacioni TRAFLED jep optical unit/LED module IP65 dhe produkti është slim. Pra është krahasuar komponenti i gabuar. Kjo arsye duhet të hiqet pavarësisht zhvillimeve të TRAFFIKS.




Figura 9. TRAFLED: slim design dhe optical unit/LED module me IP65 protection.

8.3 TRAFLED - temperatura dhe EN12368 A/B/C

TRAFLED është i certifikuar A/B/C sipas EN12368 dhe deklaron -40/+60°C. Sipas klasifikimit EN12368, ekstremet e klasave A/B/C arrijnë -40°C dhe +60°C; +65°C është kërkesë shtesë numerike e FDT-së jashtë këtij klasifikimi. Ne nuk fshehim diferencën 5°C; kërkojmë që ajo të vlerësohet me të njëjtin standard që AK përdor për ZIRSlim. Nëse ZIRSlim pranohet me A/B/C pa +65°C të provuar, TRAFLED duhet të trajtohet njësoj.

8.4 Ekaldes - prodhues, konfigurim tender-specific dhe "nuk është në fotografi"

AK vetë ka pranuar në vendimin fillestar se dimensioni bazë i bollardit Ekaldes mund të modifikohet nga prodhuesi sipas kërkesës. Kjo pranon se Ekaldes është prodhues dhe konfigurimi final mund të përshtatet sipas FDT-së. Nuk është konsistente të pranohet personalizimi për dimensionin, por të refuzohen dy shirita reflektues, ring 360°, numri i LED-ve apo memory effect vetëm sepse nuk shihen në një fotografi. Veti mekanike si elasticiteti nuk mund të vlerësohen nga fotografia, ndërsa numri/pozicioni i LED-ve mund të sqarohet me drawing/BOM të prodhuesit.

teknike nga Aneksi 1 i dosjes së tenderit për për këto dy pajisje rezulton:

2.1	KËRKESA për Shtyllat fleksibile me LED drita në maje për vendkalim të këmbësorëve		Produkti i EKALDES
1	Dimensionet e shtyllës	**Ø130 x 774mm**	Min. Ø125 x 700mm, mirëpo prodhuesi deklaron se mund të modifikohet sipas kërkesës – plotëson kërkesën
2	Materiali i shtyllës	**PU (Poliuretan)**	aluminium / PU – plotëson kërkesën
3	Ngjyra e shtyllës	**E Hirit Antracid (RAL 7016)**	Sipas kërkesës të gjitha ngjyrat – plotëson kërkesën
4	Folia reflektive	**E vendosur në maje të shtyllës me dy shirita me folie 3M apo e ngjashme (ngjyra: e bardhë ose e verdhë)**	Nuk ka, nuk është paraqitur as në fotografi **– Nuk plotëson kërkesën**
5	Rezistenca në goditje	**Trup elastik me memorie i cili pas goditjes kthehet në gjendje paraprake**	Nuk është elastik, nuk është paraqitur as në fotografi **– Nuk plotëson kërkesën**
6	Përbërja e shtyllës	**Unazë me drita LED e vendosur në maje e dukshëm 360 shkallë**	Dritat LED të vendosura përgjatë shtyllës e jo në maje të dukshëm 360 shkallë **– Nuk plotëson kërkesën**

Figura 10. Vendimi i parë për Ekaldes: personalizimi pranohet për dimensionin, ndërsa pika të tjera refuzohen sepse "nuk janë paraqitur në fotografi".

8.5 Ekaldes Ground LED - produkt custom dhe sqarimi teknik

Dokumentacioni Ekaldes e përshkruan sistemin me "custom extruded aluminium profile casing" dhe prodhim sipas vizatimeve/specifikimeve. Për dimensione, Matrix110°, PLCC6 3535, IP/IK dhe materiale, nëse dokumenti nuk ishte mjaft i qartë, AK duhej të dallonte "nuk tregohet" nga "nuk plotëson" dhe të kërkonte sqarim në të njëjtat kushte që tani ia ka ofruar TRAFFIKS.

System Specifications

a solid aluminum cover-supported box mounted inside a custom extruded aluminum profile casing , a silica- coated LED signal transmitter module secured with plastic holders to prevent liquid contact, an electronic circuit control board that manages variable signals from an external system source, and a 24V DC internal power supply.

uses a power supply that provides AC 220V input - DC 24 volt output, receiving AC 220V variable signals from an external circuit source via a 5*0.50 NYAF cable. The product is controlled by an electronic circuit control board that is powered by electricity. The electronic circuit board, which converts the AC 220V variable signals from the external system source into a DC 24-volt output, powers the LED modules and provides a homogeneous light distribution with the support of the solid material on the casing. The product casing features UV printing with liquid-resistant logos, names, or directional markings.

Extrusion: A process of continuously shaping materials under pressure, both in hot and cold states.

Figura 11. Ekaldes - "custom extruded aluminium profile casing" dhe konfigurim sipas specifikimeve/vizatimit teknik.

8.6 Deklaratat e konformitetit Ekaldes - forma e dokumentit dhe trajtimi i barabartë

TSR nuk pretendon se ISO/EN40 zëvendësojnë automatikisht IEC/EN60598, EN62493 dhe IEC/EN62031. Argumenti ynë është procedural dhe krahasues: nëse AK vlerësoi se dokumentacioni teknik i prodhuesit nuk ishte forma e veçantë e EU DoC që kërkohej, kishte në dispozicion nenin 38 për sqarim. Kjo bëhet vendimtare tani që AK pikërisht për mungesën e EU DoC të bollardit të TRAFFIKS ka lëshuar B47 dhe i ka lejuar dokument plotësues. Neni 38.4 nuk lejon që kjo mundësi t'i jepet vetëm njërit operator.

IX. KUALIFIKIMI JURIDIK I DOKUMENTEVE PLOTËSUESE TË TRAFFIKS VA

Nga analiza e mësipërme rezultojnë tre kategori juridike të ndryshme dhe AK duhet t'i dallojë qartë:

- Sqarim i lejuar: dokument që vetëm qartëson një fakt/karakteristikë të të njëjtit produkt të ofertuar dhe objektivisht dëshmon një gjendje që ka ekzistuar para skadimit të afatit për dorëzim, 31.08.2026.
- Dokument i pamjaftueshëm: dokument i ri që nuk është prova e kërkuar (p.sh. deklaratë në vend të certifikatës/atestit që vetë AK e ka kërkuar), nuk përmban standardet e FDT-së, ose nuk ka elemente objektive që tregojnë se prova ka ekzistuar para afatit.
- Ndryshim material i palejuar: zëvendësim i produktit/modelit të ofertuar (p.sh. TSL-R në vend të TL-R), transferim i karakteristikave nga një model/prodhues tjetër, ose krijim pas afatit i bazës së re të certifikimit/përputhshmërisë që mungonte në tenderin origjinal. Kjo nuk është më 'qartësim'; ndryshon identitetin ose përmbajtjen materiale të ofertës.

Dokumentet e reja të TRAFFIKS bien, së paku pjesërisht, në kategorinë e dytë dhe të tretë. Prandaj nuk mund të aprovohen në bllok si 'sqarime'. Për secilin dokument AK duhet të tregojë: cili fakt i ofertës origjinale po sqarohet; ku është identifikuar i njëjti produkt/model në ofertën e dorëzuar; dhe cila provë objektive tregon se gjendja përkatëse ekzistonte para 31.08.2026. Pa këtë test, pranimi i dokumentit të ri rrezikon të shndërrohet në ndryshim material të tenderit.

X. KONSTATIMI PËRFUNDIMTAR

Rivlerësimi ka konfirmuar thelbin e kërkesës së parë të TSR-së: oferta e TRAFFIKS VA kishte dokumente të kërkuara që nuk ishin dorëzuar me ofertë dhe AK vetë i ka identifikuar këto mungesa. Dokumentet e reja nuk mund të pranohen thjesht sepse janë dorëzuar pas B47. Deklarata ZIR nuk është certifikata/atesti EN50556/EN12675 ose certifikata SIL3 që vetë AK kërkoi dhe, për më tepër, deklaron se prodhuesi i kontrollerit është SWARCO Technology ApS; DoC i bollardit është për modelin TSL-R, jo TL-R, dhe nuk përmban standardet e kërkuara; letra ZIR-Elektromodul është e datës 26.08.2026, pra pas shpalljes së tenderit, dhe nuk tregon kur ka lindur marrëdhënia; katalogu i ri nuk dëshmon disa parametra të detyrueshëm. Këto nuk janë thjesht boshllëqe formale: aty ku dokumenti i ri ndryshon modelin, prodhuesin ose krijon për herë të parë bazën e përputhshmërisë, kemi ndryshim material të palejuar sipas nenit 59.2 LPP dhe nenit 38.2 të Rregullores.

Në të njëjtën kohë, TSR është eliminuar pa iu dhënë mundësi sqarimi për çështje të së njëjtës ose më të vogël natyrë dokumentare. Ky është standard i dyfishtë i drejtpërdrejtë: për TSR, paqartësia u trajtua si mosplotësim përfundimtar; për TRAFFIKS, mungesa e dokumentit u

trajtua si e korrigjueshme dhe iu dha B47. Neni 7 i LPP-së dhe neni 38.4 i Rregullores nuk lejojnë që instrumenti i sqarimit të përdoret selektivisht për të shpëtuar vetëm njërën ofertë.

Përfundimi
Nëse AK mban standardin strikt të përdorur ndaj TSR-së, TRAFFIKS VA duhet të shpallet i papërgjegjshëm për mungesat e pakuruara dhe dokumentet/modelin që nuk përputhen. Nëse AK zgjedh standardin e sqarimit/ekuivalencës, ai standard duhet të zbatohet në kushte të njëjta edhe ndaj TSR-së dhe oferta jonë duhet të rivlerësohet pas sqarimeve të njëjta.

XI. KËRKESAT KONKRETE NDAJ AUTORITETIT KONTRAKTUES

Në bazë të nenit 108/A të LPP-së, kërkojmë nga Autoriteti Kontraktues që:

- Të aprovojë këtë kërkesë për rishqyrtim dhe të anulojë vendimin e ri të nxjerrë pas rivlerësimit, në pjesën ku TRAFFIKS VA konsiderohet ofertues i përgjegjshëm / rekomandohet për kontratë;
- Të konstatojë se "Declaration of Conformity" e ZIR nuk është certifikata/atesti EN50556 dhe EN12675 që FDT dhe vetë B47 e kanë kërkuar;
- Të konstatojë se dokumenti ZIR që liston IEC61508 SIL-3 nuk është "certifikata SIL3" që vetë AK kërkoi në pikën 4 të B47, ose, nëse e pranon si provë ekuivalente, t'i japë TSR-së të njëjtën mundësi sqarimi për VEGA;
- Të konstatojë se EU DoC i SR-CITY-BALI-TSL-R nuk mund të përdoret për SR-CITY-BALI-TL-R dhe se, në çdo rast, DoC i sjellë nuk përmban standardet IEC/EN60598, EN62493 dhe IEC/EN62031 të kërkuara;
- Të verifikojë sipas nenit 38.3 nëse marrëdhënia ZIR-Elektromodul ekzistonte objektivisht para 31.08.2026. Letra e datës 26.08.2026, e krijuar pas publikimit të tenderit, provon vetëm se një konfirmim është lëshuar në atë datë; ajo nuk përcakton kur ka filluar marrëdhënia dhe nuk mund të përdoret automatikisht për të plotësuar zinxhirin e autorizimit pa këtë verifikim;
- Të identifikojë dokumentin e ofertës origjinale që provon secilin parametër të kontrollerit: 64 signal groups, 40 detektorë, 128 I/O, IP54, 230VAC, -40/+60°C, 2W, degree of saturation dhe C-ITS/V2X;
- Të adresojë mospërputhjet e paadresuara ZIRSlim: certifikatën 2/23 pa tabelat e intensitetit/phantom, 210 mm dhe +65°C;
- Të adresojë SR-CROSSLED-L "Linear 110°" kundrejt "Matrix 110°" dhe steady/pulsing me të njëjtin standard të përdorur ndaj Ekaldes;
- Të konstatojë se çdo dokument i ri që ndryshon modelin e ofertuar (TL-R → TSL-R), sjell për herë të parë bazë të re certifikimi/përputhshmërie ose transferon prova nga një prodhues/model tjetër përbën ndryshim material dhe nuk mund të pranohet si sqarim sipas nenit 59.2 LPP dhe nenit 38.2 të Rregullores; njëkohësisht, nëse AK përdor nenin 38.4 për paqartësi të vërteta, t'ia sigurojë TSR SH.P.K. të njëjtën mundësi sqarimi për VEGA/SIL3 dhe dokumentet Ekaldes.
- Të heqë arsyen faktikisht të gabuar për TRAFLED/IP65 dhe të rivlerësojë temperaturën TRAFLED sipas të njëjtit standard EN12368 A/B/C që zbatohet ndaj ZIRSlim;
- Të verifikojë origjinën/versionin dhe datën e ekzistencës së dokumenteve plotësuese, duke marrë parasysh kërkesën e nenit 38.3 për gjendjen para publikimit të Njoftimit për Kontratë;

- Pas rivlerësimit të barabartë, nëse TSR SH.P.K. konstatohet i përgjegjshëm, të zbatohet kriteri i shpallur "çmimi më i ulët", pasi oferta e TSR prej 112,985.00 € është më e ulët se oferta e TRAFFIKS VA prej 118,454.60 €.

XII. LISTA E PROVAVE DHE DOKUMENTEVE TË REFERUARA

- Kërkesa paraprake për rishqyrtim e TSR SH.P.K.;
- B47 - Letër Standarde e kërkesës për informata/sqarime e AK-së, datë 12.10.2026;
- Përgjigjja e TRAFFIKS VA ndaj kërkesës për informata;
- ZIR - Declaration of Conformity për ITC-3PL / EN50556 / EN12675 / IEC61508 SIL-3;
- ZIR-SSR Product Catalogue 2026, përfshirë faqen e ITC-3PL;
- ZIR Authorization / Confirmation of Representation për Elektromodul-Promet;
- SERNIS EU Declaration of Conformity për SR-CITY-BALI-TSL-R;
- Oferta e TRAFFIKS VA dhe katalogët ZIRSlim, SR-CITY-BALI-TL-R, SR-CROSSLED-L;
- Dosja e Tenderit / FDT / Aneksi 1 dhe sqarimet e AK-së të datës 12.08.2026;
- SCAE VEGA 2022, VEGA DoP, TRAFLED datasheet dhe certifikimet EN12368/EN50556;
- Dokumentacioni Ekaldes për bollard dhe pedestrian ground LED;
- Ligji Nr.04/L-042 për Prokurimin Publik, me ndryshimet në fuqi;
- Rregullorja Nr.001/2022 për Prokurimin Publik, veçanërisht nenet 38, 40 dhe 59-64.

Nga sa u tha më sipër propozojmë që Paneli Shqyrtues të merr këtë:

VENDIM

MIRATOHET si e bazuar ankesa ashtu që aktiviteti i prokurimit kthehet në **RIVLERËSIM.**

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Do të precizohen.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) *një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
b) *një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".*
c) *një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
d) *një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
e) *bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,*
f) *Dëshminë e pagesës se tarifës se ankimit ne përputhje me nenin 118 te LPP-se, dhe*
g) *të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*